


Respekt për të drejtat e viktimave të trafikimit – Fund Stigmës

- Viktimat e trafikimit si çdo qenie tjetër njerëzore meritojnë të jetojnë një jetë me dinjitet!
- Një viktimë trafikimi ka nevojë për mbështetje dhe shërbime për të filluar një jetë të re pas eksperiencës së trafikimit. Mungesa e mbështetjes dhe ndihmës bën që viktimat të jenë pre e lehtë për ri-trafikim!
- Diskriminimi dhe stigma bëhet një armë që vret shpresat dhe mundësitë e viktimave.

T'i japim fund stigmës dhe diskriminimit të viktimave të trafikimit në Shqipëri!

Nëse nuk mundesh ta ndihmosh një viktimë trafikimi, minimumi që mund të bësh për të është të mos e dëmtosh më tej duke e diskriminuar!



Publikimi i këtij materiali është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinioni, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autor-it/ëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

**RESPEKT PËR TË DREJTAT E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT NË SHQIPËRI!
FUND STIGMËS DHE DISKRIMINIMIT!**



Viktimat e trafikimit janë viktima krimi!

Askush nuk është i imunizuar nga trafikimi!

- Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim i rëndë dhe me pasojë të rënda për shëndetin dhe mirëqenien e viktimave të trafikimit.

Shumë shpesh kjo nuk kuptohet, faji u hidhet viktimave dhe jo kriminelëve dhe viktimat e këtij krimi përballen me **stigmatizim** dhe diskriminim nga shoqëria.

Si shfaqet stigmatizimi e diskriminimi?

- Kur punëdhënësi kupton se personi që kërkon punë ka patur një histori trafikimi refuzon ta punësojë;
- Kur kolegët e punës mësojnë pjesë të historisë së trafikimit e mënjanojnë, nuk pranojnë të punojnë me të;
- Kur shoqëria e vjetër apo ajo e saponisur nuk e fton më nëpër festa apo në kafe dhe bëjnë sikur nuk e vë re kur i kalon pranë;
- Kur familja i mbyll derën „se i ka prishur emrin“;
- Kur në shkollë nuk e pranojnë, se kanë frikë se u shkakton probleme, „...se nuk e ka mendjen për shkollë“;
- Kur mjekët e infermierët kërkojnë një sërë dokumentash të panevojshme apo e përcjellin sa tek njëri tek tjetri;

“Të respektosh të drejtat e viktimave të trafikimit është detyrim ligjor, por mbi të gjitha është detyrim moral i të gjithë shoqërisë”

Oë në vitin 2010 në Shqipëri vepron ligji Nr. 10 221,

“Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.

Mëso më shumë për këtë ligji!

Ligji vepron:

- Në fushën e punësimit;
- Në fushën e arsimit;
- Në fushën e ofrimit dhe përfitimit të të mirave dhe shërbimeve;

Përdore këtë ligj në të gjitha fushat e tij!

Për të garantuar mbrojtje të efektshme nga diskriminimi, në kuadër të këtij ligji, është ngritur Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një organ i pavarur barazie me qendër në Tiranë.

Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga

Diskriminimi.

Tel: 04 243 1078

E-mail: info@kmd.al